



06/061 1439-1/2024  
30 05 24

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Departman budžeta - Budget Department

DATE	30.05.2024
REFERENCE	NV-88/2024
PËR/ZATTO:	z. Nubi Mani, Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Anton Ahmeti, U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion i Departamentit të Buxhetit për Vlerësimin e Ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin "Energjia Diellore fotovoltaike në KEK-Porta Globale"

I nderuar z. Mani

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin "Energjia Diellore fotovoltaike në KEK- Porta Globale" të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), formularin për vlerësimin e ndikimit buxhetor të paraqitur nga MFPT-ja, obligimin sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Departamenti i Buxhetit paraqet me sa vijon:

#### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen e Financimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin "Energjia Diellore fotovoltaike në KEK - Porta Globale".  
Realizimi i këtij projekti do të rezultojë në 100MW kapacitet prej energjisë së ripërtëritshme që është në linjë me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031.

## OPINIONI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB) NGA ORGANI PROPOZUES

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Zyra Ligjore si organ propozues ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin "Energjia Diellore fotovoltaike në KEK- Porta Globale" dhe e ka paraqitur në formularin për vlerësimin e ndikimit buxhetor. Kjo kredi në vlerë prej 33,000,000 euro është nën-huazim e cila i dedikohet Ndërmarrjes Publike-Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-ut) ku do të implementoj projektin Energjia diellore Fotovoltaike në KEK – Porta Globale dhe si e tillë nuk përfshihet në ndarje të rregullta buxhetore. Shpërndarja e disbursimit të kredisë nëpër vite është me sa vijon:

Financim nga Huamarrja	2024	2025	2026	Totali 2024-2026
Investime kapitale	7,000,000	14,000,000	12,000,000	33,000,000
<b>Totali</b>	<b>7,000,000</b>	<b>14,000,000</b>	<b>12,000,000</b>	<b>33,000,000</b>

### Përfundim

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve vlerëson se Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin "Energjia Diellore fotovoltaike në KEK- Porta Globale" është në vlerë prej 33,000,000 euro në total. Kjo kredi është nën-huazim prandaj si e tillë u alokohet direkt Ndërmarrjes Publike Korporatës Energjetike të Kosovës dhe nuk përfshihen në ndarje të rregullta buxhetore.

Si të tilla nën huazimet janë të përfshira vetëm në tabelën 1.1 Financimi i bilancit buxhetor dhe llogariten në stokun e borxhit publik të cilat janë të paraqitura në tabelën 1.

Përgatitur nga: Jehona Ademi, Analiste e Lartë e Buxhetit

